



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 74.
Prishtinë, më 16.07.2013 në ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, Glauk Konjufca, Vesna Mikic, Jelena Bontic, Rasim Demiri, dhe Mursel Halili.

Munguan: Jasmina Živković, Mufera Sinik, dhe Petar Miletic.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-së, Elita Vokshi, përfaqësuese e Ambasadës Zvicerane Sakibe Jashari, përfaqësues nga IND- ja Xhemajl Jashari, përfaqësues i Sekretariatit të KKK - Zijush Ahmeti, përfaqësues i zyrës së Presidencës (ZPRK) Ukë Gashi dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës- Celal Iilaz.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit, Koordinatorë - Natasa Prica-Tishma, zyrtarë e lartë ligjore- Drita Çarkaxhiu, praktikante Fjolla Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: **Elmi Recica**, zëvendeskryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura më 5.07.2013 dhe 11.07.2013;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L 206 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03-L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi - konstatoi se janë krijuar kushtet për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të mbajtura me 5.07.2013 dhe 11.07.2013.

Kryesuesi - konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjeve të mbajtura më 5.07.2013 dhe 11.07.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.04/L 206 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03-L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës;

Kryesuesi, theksoi se si komision funksional, do të shqyrtohet në parim Projektligji nr.04/L 206 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03-L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Në fjalën e tij tha, se projektligji ka paraparë vetëm ndryshimin në nenin 1, me plotësim të komunitetit malazez dhe atij kroat. Mendon se Projektligji duhet të plotësohet për sa u përket komuniteteve pakicë, duke u bazuar në marrëveshjen për normalizimin e raporteve në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë. U ndërlidh se vendimi është politik dhe se për këtë çështje është akorduar edhe Qeveria . Është paraparë që në Këshillin Konsultativ për Komunitete të bëhet plotësimi me një përfaqësues të komunave me shumicë serbe. Një marrëveshje e tillë është ratifikuar në Kuvend.

Glauk Konjufca, sa i përket shqyrtimit të këtij projektligji, ai ceku se i njëjti paraqet probleme në dy aspekte. E para, në Kosovë po krijohet një praktik, që të drejtat e komuniteteve po ratifikohen me reprezentacion, që do të thotë ka më shumë poste të rezervuara për komunitete, ndërsa në realitet kjo nuk ju kontribuon të drejtave të tyre. Aspekti i dytë është çështje politike, nga se nuk është ligj i Kosovës që ka ardhur vetvetiu si nevojë për të shqyrtuar të drejtat e komuniteteve por është ligj që ka ardhur drejtpërdrejt nga marrëveshja me Serbin, e cila Kosovën ende e konsideron pjesë të kushtetutës së vetë. Këto janë arsyet për të cilat voton kundër këtij ligji.

Kryesuesi, theksoi se përkundër përpjekjeve dhe angazhimeve të vazhdueshme, Kosova është krijuar me marrëveshje ndërkombëtare që është produkt i bisedimeve dhe arritja e finalizimit të pakos së Ahtisarit. Në kuadër të këtij aspekti kemi dëshmuar se jemi shtet i hapur që komuniteti jo shumicë të jete sa më i avancuar. Përkundër diskutimeve , ai bëri ftesë që komisioni ta votojë ndryshim plotësimin e Projektligjit nr. 03-L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Glauk Konjufca, theksoi se si komunitet trajtohen edhe komuniteti shqiptarë. Në aspektin e reprezentacionit konsideron se ligji është diskriminues për komunitetin shqiptar. Nëse kthehet në shifra vota ime si qytetar i Republikës së Kosovës për arsye të vendeve të rezervuara nuk vlen 1 vote për 0.88%, e cila ndodh vetëm në Kosovë dhe nuk haset në asnjë shtet tjetër të Evropës. Konsideron se të gjithë qytetarët e vendit tonë duhet të jenë të barabartë edhe për peshën që ka vota e tyre. Pra kërkoi që të luftohet diskriminimi i tillë. Ishte i mendimit që thirrja për të votuar është trysni dhe tejkalim i kompetencave. Secili anëtarë i komisionit mund të shpreh mendimin e vete dhe në fund të votoj sipas bindjeve të tija politike.

Kryesuesi, si duket ka keqkuptime që thirrja për votim të mendohet si formë trysnie, sepse ligji është plotësim ndryshim të një amendamenti. Sa i përket diskutimeve për vende të rezervuara dhe çështjeve tjera që kanë të bëjnë me komunitete janë procedura të rregulluara me Kushtetutë .

Mursel Halili, sa i përket komunitetit tim nuk parashihet si problem ndryshimi që ka të bëjë me përbërjen e këshillit konsultativ për komunitete, andaj duhet të shikohet a ndikon Ligji në kufizimin e të drejtave të komuniteteve tona që jetojnë në Republikën e Kosovës. Mendon se në këtë drejtim duhet komisioni të merr një konkludim konkret dhe të votohet për këtë ndryshim plotësime të ligjit.

Kryesuesi, konstatoi se komisioni miratoi në parim Projektligj nr.04/L 206 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, dhe i njëjti dërgohet për miratim në Seancë Plenare.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me tetë vota për dhe një kundër, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

Të miratohet në parim Projektligji nr. 04/L-206 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

- 1. Të ndryshme.** pasi nuk ka temë të veçantë për të shqyrtuar, këtë mbledhje e konsideron të mbyllur, të gjithëve u falënderohet për kontributin e dhënë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetar i parë i Komisionit

Elmi Reçica